



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.311/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit B.M., për shkak të veprave penale: blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 dhe 5 të KPRK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.287/2020 të datës 16.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08 dhjetor 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.M. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.287/2020 të datës 16.09.2020.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.39/2020 të datës 23.06.2020, e ka shpallur fajtor të dënuarin B.M. për veprat penale: blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe

analoge nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 dhe 5 të KPRK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 17.02.2020 e tutje. I dënuari është obliguar në pagesën prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50€, në fondin e kompensimit të viktimave të krimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.287/2020 të datës 16.09.2020, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit B.M. av. A.A. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimin e kundërshtuar dhe lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së dytë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.171/2020 e datës 23.11.2020, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitës së procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së me që në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e shkallës së dytë kanë marrë pjesë gjyqtarët të cilët ka qenë dashur të përjashtohen. Pretendohet se në marrjen e aktgjykimit në gjykatën e shkallës së dytë në cilësi të kryetarit të kolegjit ka marrë pjesë gjyqtari Avdullah Ahmeti i cili ka vendosur gjithashtu si kryetar i kolegjit në procedurën paraprake sipas ankesës kundër aktvendimit për vazhdimin e masës së paraburgimit sipas lëndëve PN1.nr.235/2020 të

datës 27.02.2020 dhe PN1.nr.671/2020 të datës 01.07.2020. Gjithashtu edhe anëtari tjetër i kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë Driton Muharremi përveç se ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit PAKR.nr.287/2020 të datës 16.09.2020, po ashtu ka marrë pjesë gjatë procedurës paraprake me rastin e shqyrtimit të ankesës përkitazi me masën e paraburgimit sipas aktvendimeve: PN1.nr.235/2020 të datës 27.02.2020 dhe PN1.nr.540/2020 të datës 19.05.2020.

Në këtë mënyrë pretendohet se është vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 par.2 të KPPK-së, meqë rezulton se në shqyrtimin e ankesës kanë marrë pjesë gjyqtarët të cilët ka qenë dashur të përjashtohen, ashtu që përbërja e kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë nuk ka qenë në pajtim me ligjin dhe kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së dhe si e tillë kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje të cilat pretendohet.

Pretendimi përkitazi me përbërjen e kolegjit penal të gjykatës së shkallës së dytë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, del të jetë i pabazuar, përkundër faktit se qëndron fakti se në përbërjen e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë kanë marrë pjesë gjyqtarët të cilët kanë vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të cilët po ashtu paraprakisht kanë marrë pjesë edhe në shqyrtimin e ankesave për shkak të vazhdimit të masës së paraburgimit ndaj të dënuarit. Megjithatë nuk është shkelur dispozita e nenit 39 par.2 të KPPK-së, meqë në rastin konkret anëtari i kolegjit penal nuk ka vendosur për caktimin e masës së paraburgimit por përkitazi me ankesën për vazhdimin e

kësaj mase, dhe kjo nuk paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, andaj, kjo nuk paraqet bazë për përjashtimin e tyre me rastin e vendosjes sipas ankesës kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë, siç pa të drejtë pretendon mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën në tij.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.311/2020, më 08 dhjetor 2020

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka